

VENDIM
Nr.763, datë 6.12.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e nenit 224 të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, riformulohet si më poshtë vijon:

“3. Ndalohet vendosja e perdeve, errësimi i xhamave të autoveturave, si dhe përdorimi i xhamave të errëta, të fabrikuara, të pahomologuara nga prodhuesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha